

Eppc Kosovo kërkon një **Marketing Specialist** për një kompani ndërkombëtare me degë në Prishtinë, shumë inovative, e cila ofron shërbime online për biznese në Kosovë rreth digjitalizimit elektronik, e-commerce, shitjes dhe marketingut.

Përgjegjësitë Kryesore:

- Ofron konsulencë për klientët (bizneset) rreth marketingut digjital;
- Hulumton për audiencën dhe tregun specifik të klientit dhe ofron këshilla për kampanja;
- Krijon përmbajtje ("content") të veçantë për klientin duke u mbështetur në punë ekipore;
- Krijon llogari për media sociale, menaxhon kampanjat dhe ciklin e shërbimeve të marketingut për klientin;
- Ndërton raportet dhe besueshmërinë me bizneset dhe vendimarrësit;
- Zgjidh ankesat e klientëve duke hetuar problemet rreth shërbimeve për marketingun digjital;
- Zhvillon njohuritë të vazhdueshme rreth shërbimeve të marketingut;
- Krijon përmbajtje dhe kampanja sipas kërkesës dhe rekomandon ndryshime/përmirësime në bazë të ndryshimeve në treg;
- Kontribuon përmes punës ekipore për të realizuar rezultatet e planifikuara;
- Përgatit raporte dhe jep rekomandimeve për menaxhmentin.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë universitare (përbën avantazh në degët Marketing, Ekonomi, Biznes, ICT);
- Eksperiençë të ngjashme së paku dy vite në marketing B2B;
- Ka njohuri shumë të mira për menaxhimin e mediave sociale dhe krijimin e kampanjave me fokus të veçantë në Facebook;
- Ka njohuri të mira rreth Google Ads, AdsSense, dhe SEO;
- Të jetë person energjik, ambicioz dhe i/e disiplinuar në punë;
- Aftësi të shkëlqyera organizative, kreative dhe të jetë me iniciativë.

Të dhënat:

Pozicioni:	Marketing Specialist (Specialist i Marketingut);
Vendndodhja:	Prishtinë;
Pagesa:	Në nivel shumë të mirë;
Kontrata:	Sipas Ligjit të Punës;
Aplikimet mbyllen:	1 Tetor 2017.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail^{it}:

kosovo@eppc.al

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen. Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.